REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr 8060 Prot.

Lushnje , më 17.09.2025

PROJEKT- VENDIM

NR. 83 DATË 17/09/ 2025

"MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË PËR SHPËRBLIMIN E NXENËSVE EKSELENTE"

Këshilli Bashkiak Lushnje në mbledhjen e tij të datës ____/____/ 2025, bazuar në relacion e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë "Mbi përdorimin e fondit rezervë për shpërblimin e nxënësve të ekselencës", si dhe në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 *"Per veteqeverisjen vendore"*, neni 54, germa "m", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, neni 6, në Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" pika 132,shkresës me nr 1568/1 prot. Datë 16.09.2025 nga ZVA Lushnje,protokolluar në institucionin tonë me Nr.7996 prot. Datë 16/09/2024,

PROPOZOJMË;

1.Të miratojë shpërblimin për nxënësit ekselent në masën *30,000 (tridhjetmijë)* lekë për secilin nxënës.

2. Në aparatin e Bashkisë të pakësohet fondi rezervë (Programi AF,Produkti V491AAA) në vlerën prej *810,000 lekë* dhe të shtohen shpenzimet operative (Programi AA129, Produkti V111AAD) për *810,000 lekë.,*

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finances dhe Buxhetit.

4. Vendimi hyn në fuqi sipas ligjit.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
Erisa Qalliu

DREJTORIA JURIDIKE
Bedri Hida

KRYETARI BASHKISË
Eriselda Sefa

Adresa: Lagja "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 . E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr 8060 Prot. Lushnje , më 17.09.2025

RELACION

KESHILLIT BASHKIAK

"MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË PËR SHPËRBLIMIN E NXENËSVE EKSELENTË"

Të nderuar zoterinj këshilltarë!

Institucioni i Bashkisë Lushnje me shkresën Nr.7762 prot. datë 09/09/2025 i është drejtuar zyrtarisht Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Lushnje për të dërguar emrat e maturantëve me rezultate të larta në të gjitha shkollat e Bashkise Lushnje,bazuar dy kritereve të përcaktuara në këtë shkresë.

Bashkia Lushnje propozon dhënien e shpërblimit në masën 30 000 (tridhjetëmijë) lekë për secilin nxënës bazuar projekt vendimit,shpërblim ky i bërë traditë ,ku Bashkia e Lushnjes jep çdo vit për maturantët me rezultate të larta.

Informacioni i dërguar nga Zyra Vendore e Arsimit,Lushnje me emrat e maturantëve janë sipas listës bashkangjtur.

Ju faleminderit!

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagja "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com